**VENDIM**
**Nr. 1014, datë 16.12.2020**

# PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË SHPENZIMEVE ADMINISTRATIVE PËR KËRKESAT PËR PËRDORIMIN, SHKARKIMIN E UJIT DHE NDËRTIMIN E OBJEKTEVE E VEPRAVE UJORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të pikës 2, të nenit 93, të ligjit nr. 111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave të shpenzimeve administrative, që lidhen me përdorimin, shkarkimin e ujit, ndërtimin e objekteve dhe veprave ujore, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe që është pjesë përbërëse e tij.
2. Tarifat për shpenzimet administrative përfshijnë:
a) tarifën e paraqitjes së kërkesës për pajisjen me leje/autorizim;
b) tarifën e miratimit të lejes/autorizimit.
3. Tarifat e shpenzimeve administrative arkëtohen në emër Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe derdhen në buxhetin e shtetit. Një kopje e mandatpagesës ngarkohet në sistemin elektronik të lejeve dhe autorizimeve "Aplikim për përdorim burimi ujor".
4. Vendimi nr. 876, datë 14.12.2016, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e tarifave të shpenzimeve administrative", shfuqizohet.
5. Ngarkohen Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe zyrat e administrimit të baseneve ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
**Erion Braçe**

TABELA E TARIFAVE TË SHPENZIMEVE ADMINISTRATIVE

| **Nr. rend.** | **Tipat e përdorimit të burimit ujor sipas formularëve të aplikimit** | | **Tarifa e paraqitjes së kërkesës për pajisjen me leje/autorizim (në lek)** | **Tarifa e miratimit të lejes /autorizimit (në lek)** |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Kërkesë për miratimin në parim të dhënies me koncesion të përdorimit të burimit ujor sipërfaqësor | për ≤2 l/sek. | 0 | 0 |
| | | për >2 l/sek. | 0 | 0 |
| 2 | Kërkesë për leje për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për ujë të pijshëm (sisteme të furnizimit me ujë të popullatës) | për ≤2 l/sek. | 1 500 | 25 000 |
| | | për >2 l/sek. | 3 000 | 50 000 |
| 3 | Kërkesë për leje për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për ujë të ambalazhuar | për prodhim < 150 shishe/orë; përdorim ≤1 l/sek. | 2 500 | 50 000 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | për prodhim ≥ 150 shishe/orë; përdorim >1 l/sek. | 5 000 | 100 000 |
| 4 | Kërkesë për leje për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për ujitje | kur përdorimi është për ≤5 ha; ≤5 l/sek. | Në rastin e institucioneve të administratës shtetërore/ enteve, shoqërive publike/organeve të njësive të qeverisjes vendore tarifa është "0" | Në rastin e institucioneve të administratës shtetërore/ enteve, shoqërive publike/ organeve të njësive të qeverisjes vendore tarifa është "0" |
| | | | Në rastin e subjekteve/enteve private, tarifa është 1 500 | Në rastin e subjekteve/enteve private, tarifa është 5 000 |
| | | kur përdorimi është për >5 ha; >5 l/sek. | Në rastin e institucioneve të administratës shtetërore/enteve, shoqërive publike/organeve të njësive të qeverisjes vendore tarifa është "0" | Në rastin e institucioneve të administratës shtetërore/enteve, shoqërive publike/ organeve të njësive të qeverisjes vendore tarifa është "0" |
| | | | Në rastin e subjekteve/enteve private, tarifa është 3 000 | Në rastin e subjekteve/enteve private, tarifa është 30 000 |
| 5.1 | Kërkesë për leje për përdorim të burimi ujor sipërfaqësor për akuakulturë (në rastin e ujërave të rrjedhshme) | kur përdorimi është për ≤5 ton/vit; ≤5 l/sek. | 1 500 | 25 000 |
| | | kur përdorimi është për >5 ton/vit; >5 l/sek. | 3 000 | 50 000 |
| 5.2 | Kërkesë për leje për përdorim të burimi ujor sipërfaqësor për akuakulturë (në rastin e ujërave të qëndrueshme) | | 3 000 | 50 000 |
| 6 | Kërkesë për leje për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik | | 5 000 | 100 000 |
| 7 | Kërkesë për leje për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për qëllime industriale dhe teknologjike | | 3 000 | 25 000 |
| 8 | Kërkesë për leje për përdorim burimi ujor për lundrueshmëri | | 3 000 | 5 000 |
| 9 | Kërkesë për leje për përdorimin e ujërave detare për prodhim energjie elektrike | | 3 000 | 100 000 |
| 10 | Kërkesë për leje për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për qëllime të tjera (që nuk përfshihen në formularët e tjerë) | | 3 000 | 5 000 |
| 11 | Kërkesë për autorizim për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për qëllime blektorale, kur shoqërohet me instalime tubacionesh dhe ndërtime objektesh | kur përdorimi është <1 l/sek. | 1 500 | 5 000 |
| | | kur përdorimi është 1-5 l/sek. | 2 000 | 15 000 |
| | | kur përdorimi është >5 l/sek. | 3 000 | 25 000 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 12 | Kërkesë për autorizim për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për turizëm, argëtim, lundrim për argëtim | | 3 000 | 50 000 |
| 13 | Kërkesë për autorizim për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për kërkime, studime, që kanë për objekt ujin | | 0 | 0 |
| 14 | Kërkesë për autorizim për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për kërkime, studime që nuk kanë nuk kanë për objekt ujin | | 0 | 0 |
| 15 | Kërkesë e institucioneve monitoruese të ujërave sipërfaqësore e nëntokësore dhe institucioneve shkencore për autorizim për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për kërkime, studime, eksplorime që ndikojnë në prishjen e ekuilibrave sasiorë dhe cilësorë të ujërave | | Në rastin e institucioneve monitoruese dhe shkencore publike, tarifa është “0”<br>Në rastin e subjekteve/enteve private tarifa është 3 000 | Në rastin se institucioneve monitoruese dhe shkencore publike, tarifa është “0”<br>Në rastin e subjekteve/enteve private tarifa është 5 000 |
| 16 | Kërkesë për autorizim për përdorim burimi ujor sipërfaqësor, për qëllime të tjera (që nuk përfshihen në formularët e tjerë) | | 3 000 | 25 000 |
| 17 | Kërkesë për miratimin në parim për dhënien me koncesion të përdorimit të burimi ujor nëntokësor | | 0 | 0 |
| 18 | Kërkesë për leje për kryerje shpimi nëntokësor për nxjerrje uji (pus– shpimi) | | 150 | 5 000 |
| 19 | Kërkesë për leje për nxjerrje dhe shfrytëzimi të ujit nëntokësor nëpërmjet shpimit për qëllime të ndryshme (që nuk përfshihen në formularët e tjerë) | | 3 000 | 25 000 |
| 20 | Kërkesë për leje për përdorim burimi ujor nëntokësor për ujë të pijshëm (sisteme të furnizimit me ujë të popullatës) | kur përdorimi është ≤1 l/sek. | 1 500 | 25 000 |
| | | kur përdorimi është >1 l/sek. | 3 000 | 50 000 |
| 21 | Kërkesë për leje për përdorim burimi ujor nëntokësor për ujë të ambalazhuar | kur përdorimi është për ≤150 shishe/orë; ≤ 1 l/sek. | 2 500 | 50 000 |
| | | kur përdorimi është për >151 shishe/orë; >1 l/sek. | 5 000 | 100 000 |
| 22 | Kërkesë për leje për përdorim burimi ujor nëntokësor për ujitje | kur përdorimi është për ≤5 ha; ≤5 l/sek. | 1 500 | 5 000 |
| | | kur përdorimi është për >5 ha; >5 l/sek. | 3 000 | 30 000 |
| 23 | Kërkesë për leje për përdorim burimi ujor nëntokësor për akuakulturë | kur përdorimi është për ≤5 ton/vit; ≤5 l/sek. | 1 500 | 25 000 |
| | | kur përdorimi është për >5 ton/vit; >5 l/sek. | 3 000 | 50 000 |
| 24 | Kërkesë për leje përdorim burimi ujor nëntokësor për prodhim hidroenergjie | | 5 000 | 100 000 |
| 25 | Kërkesë për leje për përdorim burimi ujor nëntokësor për qëllime industriale | | 3 000 | 25 000 |
| 26 | Kërkesë për leje për përdorim burimi ujor nëntokësor për turizëm dhe argëtim | | 3 000 | 50 000 |
| 27 | Kërkesë për leje për përdorim burimit ujor kurativ, mineral, termomineral dhe gjeotermal | | 5 000 | 100 000 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 28 | Kërkesë për autorizim për shfrytëzim uji nëntokësor për qëllime familjare (jo ujë të pijshëm, sasi < 0.5 l/sek.) | | 1 500 | 5 000 |
| 29 | Kërkesë për autorizim për përdorim burimi ujor nëntokësor për qëllime blektorale, kur shoqërohet me instalime tubacionesh dhe ndërtime objektesh | kur përdorimi është ≤1 l/sek. | 1 500 | 5 000 |
| | | kur përdorimi është >1 l/sek. | 3 000 | 25 000 |
| 30 | Kërkesë për autorizim për përdorim burimi ujor nëntokësor për kërkime, studime, që kanë për objekt ujin | | 0 | 0 |
| 31 | Kërkesë për autorizim për përdorim burimi ujor nëntokësor për kërkime, studime që nuk kanë për objekt ujin | | 0 | 0 |
| 32 | Kërkesë për autorizim për përdorim burimi ujor nëntokësor e institucioneve monitoruese të ujërave sipërfaqësore e nëntokësore dhe institucioneve shkencore për kërkime, studime, eksplorime që ndikojnë në prishjen e ekuilibrave sasiorë dhe cilësorë të ujërave | | Në rastin e institucioneve monitoruese dhe shkencore shtetërore ose publike, tarifa është “0”<br>Në rastin e subjekteve/enteve private, tarifa është 3,000 | Në rastin e institucioneve monitoruese dhe shkencore shtetërore ose publike, tarifa është “0”<br>Në rastin e subjekteve/enteve private, tarifa është 5,000 |
| 33 | Kërkesë për autorizim për përdorim burimi ujor për ndërtimin, rindërtimin apo shembjen për mbrojtjen e brigjeve, mureve, pritave, veprave të mbrojtjes nga përmbytjet, e veprave të tjera në brigje | | Në rastin e institucioneve të administratës shtetërore/ enteve, shoqërive publike/ organeve të njësive të qeverisjes vendore, tarifa është “0” | Në rastin e institucioneve të administratës shtetërore/ enteve, shoqërive publike/ organeve të njësive të qeverisjes vendore, tarifa është “0” |
| | | | Në rastin e subjekteve/enteve private tarifa është 3 000 | Në rastin e subjekteve/enteve private tarifa është 100 000 |
| 34 | Kërkesë për autorizim për përdorim burimi ujor për veprimtari ndërtimore në brigje | kur përdorimi është për sip. e strukturës ≤150 m2 dhe ≤ se 5 m hyrje në trupin ujor nga vija e bregut | 3 000 | 100 000 |
| | | kur përdorimi është për sip. e strukturës >150 m2 dhe > se 5 m hyrje në trupin ujor nga vija e bregut | 3 000 | 100 000 |
| 35 | Kërkesë për autorizim për veprimtari mbrojtëse të përkohshme në rast emergjence | | 0 | 0 |
| 36 | Kërkesë për leje për përdorim burimi ujor për ndërtimin e strukturave ankoruese, portuale dhe ishujve artificialë në det | | 3 000 | 100 000 |
| 37 | Kërkesë për leje për shfrytëzimin e materialeve inerte që nxirren nga shtretërit e lumenjve, përrenjve, liqeneve me ose pa ujë | | 10 000 | 200 000 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 38 | Kërkesë për leje për rehabilitimin e trupave ujorë. Aplikohet vetëm nga bashkitë dhe institucionet publike që e kanë si funksion në fushën e përgjegjësisë | | 0 | 0 |
| 39 | Kërkesë për leje/autorizim për veprimtari të tjera në brigjet dhe shtratin e burimit ujor | | 3 000 | 25 000 |
| 40 | Kërkesë për autorizim për përdorim ose ripërdorim të ujërave të përdorura, përfshi aplikimin e tyre në tokë | | 1 500 | 5 000 |
| 41 | Kërkesë për autorizim për shkarkimin e ujërave të përdorura industrial | | 3 000 | 25 000 |
| 42 | Kërkesë për autorizim për shkarkimin e ujërave të ndotura | për sisteme me aglomerat nën 2000 p.e. | 3 000 | 25 000 |
| | | për sisteme me aglomerat mbi 2000 p.e. | 3 000 | 12 500 |
| 43 | Kërkesë për leje për ripërdorimin e ujërave të ndotura | | 1 500 | 5 000 |
| 44 | Kërkesë për leje/autorizim për shkarkimin e lëngjeve që mund të shkaktojnë infiltrimin ose akumulimin me kohë në ujërat sipërfaqësore, shtretërit natyrorë ose artificialë, shtresat ujëmbajtëse ose ujërat nëntokësore | | 3 000 | 25 000 |
| 45 | Kërkesë për rinovim të lejes/autorizimit. *Me këtë formular aplikohet vetëm në rastet ku kërkohet rinovim i një leje/autorizimi ekzistues, pa ndryshuar treguesit dhe parametrat e miratuar më parë. Në rast ndryshimi të këtyre parametrave subjekti duhet të bëjë kërkesë të re mbi leje/autorizim për përdorimin e burimit ujor, për veprimtarinë që kërkon të kryejë. | | Tarifa e njëjtë me tarifën ë aplikimit për leje/autorizim për këtë përdorim (sipas tarifave të mësipërme) | Tarifa e njëjtë me tarifën marrjes së lejes/autorizimit për këtë përdorim (sipas tarifave të mësipërme) |
| 46 | Kërkesë për transferim të lejes/autorizimit | | 1 500 | 1 500 |
| 47 | Kërkesë për pezullimin e lejes/autorizimit | | 0 | 0 |
| 48 | Kërkesë për ndryshimin të lejes/autorizimit | | Tarifa e njëjtë me tarifën ë aplikimit për leje/autorizim për këtë përdorim (sipas tarifave të mësipërme) | Tarifa e njëjtë me tarifën marrjes së lejes/autorizimit për këtë përdorim (sipas tarifave të mësipërme) |